



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1250/2 prot.,

Datë 01.06.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-66587-04-19-2023, me objekt: “*Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe dixhitale (Pajisje per kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)*” me fond limit 4,854,422 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.
- Ankimues:** “Li.Bo Albania Branch” SHPK
Lagjia Nr.3, Sheshi Liria, tek EGT Center, Ap.18, ndodhur ne ZK.8514, me numer Pasurie 3/319-N18, Kati 2,Durrës
- Autoriteti Kontraktor:** “Albanian Gas Services Company” Sh.A
Rruga “Kosovareve”, pallati: NderPro, Tirane

Në datën 31.05.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1250/2023 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3147 e operatorit ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-66587-04-19-2023, me objekt: “*Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe dixhitale (Pajisje per kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)*” me fond limit 4,854,422 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga “Li.Bo Albania Branch” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Li.Bo Albania Branch” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1250 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

- Per plotesimin e kriterit 2.2.1 ne shtojcen 7 per kontratat e ngjashme OE ka dorezuar ne SPE kopje te faturave me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 ne emer te kompanise meme italiane LI.BO SRL, te cilat nuk jane noterizuar kopjet me origjinalin por vetem noterizimi i perkthimit, si dhe mungon vula apostile. - E njejta gje konstatohet edhe ne Çertifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001-2015, e cila nuk është noterizuar kopja me origjinalin. - Nuk ploteson kriterin 2.1.1 ne shtojcen 7 per xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare , pasi nuk ka paraqitur dokument nga administrata tatimore per xhiron ose vetedeklarim nese ky dokument nuk lëshohet nga vendi i origjinës se kompanise meme LI.BO SRL , në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19/05/2021, Nenin 26 ku parashikohet shprehimisht se: Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.06.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro